

Agjencitë e Pavarura dhe të Hyrat e Dedikuara

Analizë Politikash

/2019



Agjencitë e Pavarura dhe të Hyrat e Dedikuara

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Maj 2019**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje	2
1. Cka janë agjencitë dhe cilat janë llojet e tyre ?.....	3
2. Institucionet dhe agjencitë në kuadër të kuvendit të Kosovës?.....	3
3. Llogaridhënia e agjencive.....	4
3.1 Përshkrimi I agjencive	4
4. Dallimi mes taksës dhe tatimit.....	5
4. Taksë e dedikuar dhe si aplikohet	7
6. Agjencitë e pavarura: ZRRE dhe Autoriteti i Aviacionit Civil.....	8

Hyrje

Institucionet e pavarura janë elementi kryesor i një demokracie funksionale. Sikurse edhe qeveria, institucionet dhe agjencitë e pavarura i japin llogari perfaqësuesve të zgjedhur të Kosovës që e monitorojnë punën e tyre. Kuvendi I Kosovës ka themeluar me shumë se 30 agjenci të pavarura. Pra aktualisht janë me shumë se 30 agjenci që i raportojnë drejtëpërdrejtë kuvendit të Kosovës, kryjnë llojllojshmëri të funksioneve që përfshijnë .

Agjencitë dhe institucionet e pavarura janë entitete të cilat shërbejnë për të rregulluar në mënyrë të pavarur funksione të ndryshme të jetës publike dhe ndahen në disa lloje. Formimi i disa institucioneve të pavarura, si Avokati i Popullit apo Këshilli i Pavarur për Media, është i paraparë në Kushtetutën e Kosovës. Kushtetuta gjithashtu le hapësirë për formimin e agjencive të tjera sipas nevojës qoftë nën autoritetin e Kuvendit të Kosovës apo Qeverisë. Këto agjenci dhe institucione formohen me ligje përkatëse që përfshijnë rregullorët e punës, organizimin, kompetencat, përzgjedhjen e bordeve apo drejtorëve, etj.

Përderisa institucionet e pavarura janë të parapara dhe rregulluara me Kushtetutë, agjencitë e pavarura themelohen sipas nevojës nga Kuvendi i Kosovës me kërkesë të qeverisë, përmes ligjeve specifike për to.

Te hyrat nga tatimet dhe taksat përbëjnë shtyllën kryesore prej së cilës varet qendrueshmëria financiare e shtetit. Të gjithë e dijme që taksat dhe tatimet janë detyrime financiare të paguara nga qytetarë e që në fund ju kthehen në të mira e shërbime.

Institucioni kryesor përgjegjës për mbledhjen e taksave dhe tatimeve është Administrata Tatimore e Kosovës.

Për momentin në Kosovë aplikohen këto lloje të tatimeve:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)
- Tatimi mbi të ardhurat personale
- Tatimi në të ardhurat e korporatës
- Tatimi i paragjykuar
- Tatimi në fitim
- Tatimi në pronë

1. Cka janë agjencitë dhe cilat janë llojet e tyre ?

Agjencitë e Pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të pavarura të krijuara me Kushtetutë apo ligje të veçanta. Neni 142 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton formën dhe mënyrat e themelimit të Agjencive të Pavarura. Neni në fjalë përcakton katër parime bazë që duhet ta shoqërojnë themelimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve. Ato kryjnë funksionet e tyre kryesore në mënyrë të pavarur. Pra, Kuvendi i Kosovës është autoriteti i parë kushtetues i cili i ka themeluar Agjencitë e pavarura. Kushtetuta është ajo që e përcakton se Kuvendi dhet të nxjerrë ligji përkatëse që merren me fushveprimin dhe funksionimin e tyre. Agjencië e Pavarura duhet e posedojnë buxhetin e tyre të veçantë në pajtim me ligjin. Egzistojnë dy lloje të agjencive që njihen sot në administratën publike: grupi i parë janë agjencitë e themeluara nga Kuvendi i Kosovës dhe grupi i dytë Agjencitë e themeluara në Kuader të qeverisë së Kosovës. Numri i Agjencive të Pavarura që janë themeluar nga ana e Kuvendit të Kosovës deri tani kanë arritur në 32, të cilat për punën e tyre raportojnë direkt Kuvendit.

2. Institucionet dhe agjencitë në kuadër të kuvendit të Kosovës?

- AKP Agjencia Kosovare e Privatizimit
- AKK Agjencia Kundër Korrupsionit
- AMKMK Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale
- ASHMDHP Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- ANJF Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
- ASHAK Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
- ARKEP Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
- ARH Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
- AAC Autoriteti i Aviacionit Civil
- BQK Banka Qendrore e Kosovës
- FKPK Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
- IAP Institucioni i Avokatit të Popullit
- IGJK Instituti Gjyqësor i Kosovës
- KGJK Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- KPK Këshilli Prokurorial i Kosovës
- KKTK Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë
- KPMSHC Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
- KPMM Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
- KQZ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- KRPP Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- KPM Komisioni i Pavarur i Mediave
- OSHP Organi Shqyrtues i Prokurimit
- PZAP Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
- RTK Radio Televizioni i Kosovës

- ZAP Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
- ZRrE Zyra e Rregullatorit për Energji
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
- Radio Televizioni i Kosovës.

3. Llogaridhënia e agjencive.

Agjencitë në kuadër të Kuvendit të Kosovës menaxhojnë individualisht me burimet njerëzore dhe kanë të themeluara njësi në kuadër të administratës për menaxhimin e personelit. Sa i përket agjencive në kuadër të Qeverisë, ekziston një konfuzion sa i përket çështjes se kush duhet të ketë njësi të personelit që merret me menaxhimin e burimeve njerëzore. Institucionet dhe agjencitë në kuadër të Kuvendit dhe ato në kuadër të Qeverisë nuk kanë një bazë ligjore unike për përcaktimin e pagës së anëtarëve në borde dhe personelit tjetër si nëpunës civil apo publik. Përveq agjencive, as në nivel të vendit nuk ka një ligj të vetëm apo ligje për kategori të punëtorëve për pagat dhe të cilat janë në zbatim në Kosovë.

Llogaridhënia është një aspekt kyq për funksionimin e mirë të institucioneve dhe administratës publike dhe është zhvilluar si një prej gjashtë parimeve të administratës publike. Llogaridhënia e agjencive në kuadër të Kuvendit dhe Qeverisë është e analizuar në aspektin e raportimit të tyre në Kuvend dhe Qeveri të Kosovës. Sipas këtij parimi: 48 “kushti kryesor është që të ketë mekanizma adekuat për të siguruar llogaridhënien e institucioneve dhe trupave të administratës publike duke përfshirë obligimet ligjore dhe transparencën.

3.1 Përshkrimi I agjencive

1. **Agjencia kunder korrupsionit(AKK)** është themeluar në vitin 2007. Marrëdhënia e punës në AKK është e definuar sipas Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit sa i përket marrëdhënies së punës së Drejtorit të AKK, dhe Ligjit për shërbimin civil për pjesën tjetër të stafit në AKK. Në AKK janë 40 të punësuar, 39 janë nëpunës civil dhe Drejtori i AKK-së si funksionar publik. Ky i fundit zgjedhet sipas konkursit të hapur nga kuvendi. Dy prej kandidatëve në listën e ngushtë propozohen nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, për seancë të kuvendit, dhe me votim të fshehtë, me shumicë votash, kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët për një mandat pesë vjeçar për Drejtor të AKK (me mundësi vazhdimi edhe për një mandat tjetër pesë vjeçar). Paga e drejtorit të AKK-së është e përcaktuar me Ligjin për AKK dhe është e barabartë me pagën e një kryetari të komisionit në Kuvend të Kosovës. Nëpunësit civil kanë pagë të përcaktuar në bazë të koeficientëve, ku drejtori i departamentit ka koeficient 10, udhëheqësi i divizionit 9, zyrtari i latë 8. AKK udhëheqet nga drejtori si organ individual i cili është edhe zyrtari kryesor administrativ. AKK është e organizuar në katër departamente të cilat ndahen në divizione dhe një zyre mbështetëse.

2. **Gjykata kushtetuese e Kosovës** është themeluar në vitin 2009. Marrëdhënia e punës në Gjykatën Kushtetuese është e definuar me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese⁶⁴, Ligjin e punës dhe Ligjin për shërbimin civil. Gjykata Kushtetuese ka gjithsej 65 të punësuar si staf vendor pa përfshirë tre gjyqtarë dhe dy këshilltarët juridik ndërkombëtar. Të punësuarit ndahen në gjyqtarë, këshilltarë dhe stafi drejtues profesional dhe mbështetës. Sistemi i pagave në Gjykatën Kushtetuese është i përzier, por që dominojnë elementet e sistemit të pagave fikse, bazuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, Rregulloren e punës, aktet nënligjore dhe vendimet e posaqme të Gjykatës. Punëtorët kanë paga fikse derisa aplikohen shtesa mbi pagën bazë në lartësinë nga 5-40% e pagës bazë derisa shtesa e mëhershme e këshilltarëve juridik prej 20% është përfshirë në pagën bazë. Gjykata Kushtetuese qeveriset nga organi kolegjiial që janë gjyqtarët por kryesohet nga Kryetari dhe zëvendëskryetari. Nën organin kolegjiial janë pozitat e Sekretarit të përgjithshëm dhe zëvendësit të tij nën të cilët janë të organizuara katër departamente të udhëhequr nga drejtorë, një njësi i TI dhe multimedieve e udhëhequr nga kryesuesi por në nivel të departamenteve dhe njësi e prokurimit po në këtë nivel dhe e udhëhequr nga drejtori. Gjykata Kushtetuese është e themeluar në bazë të Kushtetutës dhe pastaj me ligj të vecantë për Gjykatën Kushtetuese. Raporti vjetor i Gjykatës Kushtetuese dërgohet në Kuvend dhe tek palët tjera vetëm për njoftim/informim por nuk është raportim i Gjykatës Kushtetuese në Kuvend.

4. Dallimi mes taksës dhe tatimit

Taksat janë instrument financiar I rëndësishëm ndërmjet të cilave mblidhen mjetet financiare për mbulimin e të dalave shtetërore.

Taksa është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik.

Që në vitin 1789, ekonomisti I shquar Benjamin Franklin ka thënë : Në këtë botë nuk mund të thuhet se ka gjë të sigurt ,përveq vdekjes e taksave .pra, 226 vjet më pare, bota e ka parë si të domosdoshmë nevojën për ti paguar taksa qeverise .

Në kuptimin e sotëm taksat janë ngushtë te lidhura me zhvillimin e administratës shtetërore, fakt që ka ndikuar në zgjerimin e obligimit te pagimit te taksave. Ato janë një lloj specifik I te hyrave shtetërore të cilat I mblidhin organet shtetërore dhe oranet tjera juridiko publike prej personave public e juridik si kundërshtperblim për shërbimette cilat ua ofrojnë ketyre organeve. Karakterisike e taksave është se obliguesi vet sipas dëshirës e bëjne pagimin e taksave dhe he nxitn punën e organeve shtetërore.

Pra taksat janë të hyra shetëroretë ilat kanë karakter vullnetar psh. Qytetari për nxerrjen e dokumenteve (pasaportën ose letërnjoftimin) mirëpo nëse qytetari nuk e paraqet kërkesën për këto dokumente atëhere nuk paguan taksë.

Klasifikimi I taksave:

Sipas organeve të cilat e caktjnë obligimit e pagimit të taksave dallojme :

- a) Taksat që përaktojnë organet shtetërore qendrore
- b) Taksat që i caktojnë bashkësitë e ngushta politiko-shoqërore.

Sipas organeve të cilat i kryejnë shërbimet e caktuara:

- a) Taksat administrative (taksat dognore ,taksat konsullare, taksat për qarkullimin e veturave të huaja ,taksat për mbrojtjen e patentave ,licencave.
- b) Taksat gjyqësore të cilat paguhën për procedurat gjyqësore të rregullta

Sipas mënyrës së pagimit të taksave dallojmë :

- a) Taksat që paguhën në marka takes, të cilat paguhën për shkresa
- b) Taksat që paguhën në para të gatshme

Sipas kohës së pagimit të taksave:

- a) Taksat që paguhën përpara
- b) Taksat që paguhën prapa

Sipas numrit të shërbimeve të kryera :

- a) Taksat individuale
- b) Taksat paushalle

Taksat ndahen në : Taksa të përgjithshme , taksa speciale, taksat e perhershme ,taksat e ndryshueshme .

Tatimi është shumë e caktuar që secili qytetar i paguan shtetit për pasur dhe të ardhurat që i ka , ato janë të perhershme dhe paguhën rregullisht.

Pra është pagesë që shkon në bugjetin e shtetit , është e detyrueshme dhe e pakthyeshme .Tatimet mund të jenë direkte dhe indirekte .tatimet që aplikohen në Kosovë janë tatimi mbi vlerën e shtuar,tatimi në të ardhura personale ,tatimi në të ardhura të korporatave ,tatimi në lojrat fatit ,dhe kontributet pensionale , ku këto përfaqësohen tek administrata tatimore e Kosovës , pastaj janë taksat doganore dhe akcizat që mbështeten nga Dogana e Kosovës dhe Tatimi mbi pronën dhe taksat lokale që janë në kuadër të komunave .

Në shtetet skllavopronare dhe feudale qëllimi kryesor i tatimit ishte mbledhja e mjeteve financiare për plotësimin e nevojave shtetërore , kryesisht të nevojave mbretërore të njerzve të oborrit mbretëror .Ndërsa në ato kapitaliste zgjerohet roli i shtetit dhe me këtë ndryshojnë edhe qëllimet e tatimit .Qëllimet e tatimit ani nuk janë vetëm fiskale por edhe qëllime jo fiskale përmes e cilave realizohen qëllimet e shumta të politikës financiare .

Tatimet mund të klasifikohen në :

- Tatime të drejtpërdrejta dhe të zhdrejta
- Tatime kadastrale dhe tarifore
- Tatime të rregullta dhe të jashtëzakonshme
- Tatime personale dhe subjektive

- Tatime fundore dhe jofundore
- Tatime qendrore dhe lokale

Taksat dhe tatimet dallojnë për nga perkufizimi, qëllimi dhe natyra e tyre.

Taksat mund të mos paguhen në baza të rregullta kohore pasi që ato paguhen vetëm kur e marrim shërbimin e caktuar, ndërsa tatimet janë të perhershme dhe s'këmben tilla paguhen rregullisht.

Te këmbim të taksës së paguar, individit do të duhej të kishte përfitime individuale, ndërsa në këmbim të tatimeve të paguara përfitimet janë kolektive.

4. Taksa e dedikuar dhe si aplikohet

Taksa e dedikuar apo ndryshe e njohur si taksa e hipotekuar njihet si e tillë kur paratë e mbledhura nga një burim i caktuar përdoren në mënyrë specifike për një shërbim të caktuar, përkundër shpërndarjes së kësaj shumë për mbulimin e shpenzimeve të ndryshme buxhetore. Ekzistojnë dallime të theksuara në mes të taksës së dedikuar dhe tatimeve në përgjithësi. Përderisa tatimi ka për synim rritjen e të hyrave, taksa ka për qëllim mbulimin e shërbimit të ofruar. Pra, taksa vendoset ekskluzivisht për mirëmbajtjen e një shërbimi të caktuar dhe të hyrat e tilla përdoren për qëllimin për të cilin mblidhen. Taksat janë një instrument i rëndësishëm për të mbuluar shpenzimet shtetërore. Kjo pasi disa degë të caktuara e kanë të siguar mbijetesën e tyre falë taksave përkatëse.

Taksa e dedikuar jo domosdoshmërisht mbulon gjithë koston e shërbimit. Shteti mund të mbulojë një pjesë të konsiderueshme të shërbimit të ofruar, dhe pastaj një pjesë simbolike të mblidhet përmes taksës së dedikuar. Në rastin e përgjithshëm, taksa e dedikuar nuk mund të përdoret për të mbuluar shërbime të tjera shtetërore.

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike, në nenin 2 të tij përcakton taksat si para publike të cilat duhet patjetër të grumbullohen në buxhetin e Kosovës. Të gjitha paratë publike duhet të depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me Rregullat e Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar (KMF) dhe paratë publike mund të shfrytëzohen ose shpenzohen vetëm pasi që të jenë ndarë në mënyrë të rregullt sipas këtij ligji.

Në Kosovë, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike ë ardhurat e dedikuara është i paqartë sa i përket entiteteve financiare të pavarura dhe taksës së dedikuar. Ligji njihet të ardhurat e dedikuara si kategori por ky konsiderim vjen në shprehje vetëm kur bëhet ndarja e buxhetit nga Qeveria qendrore.

Rasti i të hyrave vetanake komunale paraqet rastin e të hyrave të cilat trajtohen si të ardhura të dedikuara. Për shembull, komunat mbledhin një të hyrë të dedikuar siç është tatimi në pronë. Pasi të mblidhet si e hyrë, tatimi në pronë derdhet në buxhetin e Kosovës. Më pas, kur bëhet ndarja buxhetore, Ministria e Financave, në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, i kategorizon këto të hyra si të hyra të dedikuara dhe i transferon prapa tek komunat që t'i shfrytëzojnë në vitin pasues financiar. Si e hyrë e dedikuar, ajo nuk mund të kthehet më prapa në

Qeverinë e Kosovës pavarësisht se a mbetet suficite apo jo, siç ndodhë për shembull me grantin qeveritar, të cilin komunat zakonisht nxitojnë ta shpenzojnë para fundit të vitit fiskal. Pra, taksat e dedikuara duhet të mbulojnë koston e shërbimit të caktuar dhe niveli i saj duhet të indeksohet varësisht nga shpenzimet e koston së atij shërbimi.

Taksat janë quajtur edhe të hyra vullnetare të cilat i realizon shteti. Arsyeja për një gjë të tillë ka të bëjë edhe me faktin që edhe pse shteti kushtëzon shërbimin me taksën e ofruar, ajo nuk mund të detyrojë qytetarin për të marrë atë shërbim. Gjithashtu, taksa paguhet vetëm në momentin kur qytetari merr shërbimin, pra për shembull kur aplikon për një dokument të caktuar apo shërbim tjetër. Kjo do të thotë që shërbimi i ofruar është alternativ dhe jo i domosdoshëm. Qytetari mund të vendosë të mos e regjistroj fare automjetin e tij, nëse nuk pajtohet të paguajë taksën ekologjike, mirëpo në rast të tillë ai do t'i ekspozohet rrezikut për gjokitje për qarkullim jo të rregullt në komunikacion.

6. Agjencitë e pavarura: ZRRE dhe Autoriteti i Aviacionit Civil

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) u themelua në qershor 2004, me shpalljen nga Parlamenti i Kosovës të Ligjit për Energjinë, Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Zyra e Rregullatorit për Energji është organ i pavarur, i cili ka për detyrë të rregullojë aktivitetet në Sektorin e energjisë në Kosovë, përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen qendrore dhe gazin, në pajtim me detyrimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (Ky traktat është nënshkruar nga Bashkimi Evropian dhe nëntë partnerë nga Evropa Juglindore në Athinë në muajin tetor 2005 për krijimin e kornizës ligjore për një treg të integruar të energjisë)

ZRRE financohet nga taksat e licencave, të cilat i mundësojnë kësaj zyre të veprjë si organ rregullator i pavarur financiarisht. ZRRE ndihmon dhe siguron që korniza rregulluese e Kosovës të jetë në pajtim me 'acquis communautaire' (përmbledhja e legjislacionit të BE-së) për energjinë.

ZRRE-ja drejtohet në pajtim me Kreun 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Ajo drejtohet nga pesë anëtarë të Bordit, duke përfshirë kryesuesin e Bordit i cili njëherit është edhe udhëheqës i ZRRE-së. Anëtarët e Bordit përmbushin detyrat dhe obligimet në përputhje me përgjegjësitë që parashihen me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë.

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) është themeluar me Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil si agjenci e pavarur rregullatore për aviacionin civil. AAC-ja është përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës. Aktivitetet në aviacionin civil në hapësirën ajrore të Kosovës zhvillohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Aviacionin Civil, Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar të datës 7 dhjetor 1944 dhe Marrëveshjen për Themelimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Kosova posedon kornizën e duhur ligjore për aviacionin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve në aviacion. Vazhdimisht hartohen rregullore dhe kërkesa ligjore për të përputhur legjislacionin dhe procedurat e aviacionit të Kosovës me kërkesat ndërkombëtare, siç janë Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe veçanërisht me kuadrin ligjor të BE-së si pjesë e detyrimeve tona sipas Marrëveshjes së Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, në të cilën Kosova është

palë kontraktuese. Në AAC aplikohet sistem i pagave i paraparë me nenin 24.1 të Ligjit për aviacionin civil, të miratuara nga Ministri i Financave. Pra, jashtë sistemit të pagave të nëpunësve civilë. Bazuar në miratimin e nivelit të pagave nga Ministri i Financave, MAP ka përcaktuar koeficientët korrespondues, të veçantë për AAC-në. Ligji për aviacionin civil parasheh se drejtori i përgjithshëm i propozon Ministrin të Financave një sistem pagash duke marrë parasysh nivelin e aftësisë së dëshmuar, arritjet arsimore, përvojën dhe njohuritë e dëshmuara dhe konkurrencën e pagave me industrinë e aviacionit. Në bazë të Ligjit për aviacionin civil, AAC i raporton një herë në vit Kuvendit të Kosovës. Përgjegjësitë dhe vijat e llogaridhënies në mes AAC dhe Kuvendit të Kosovës janë të përcaktuar me nenin 19 të Ligjit për aviacionin civil.